

Nr. 15/ZDP/VE/2024  
13 dhjetor 2024

Në mbështetje të nenit 14.1, 15.1(f), 21.2 dhe 81 të Ligjit nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil, i ndryshuar me Ligjin Nr.08/L-063 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me racionalizimin dhe vendosjen e vijave llogaridhënëse të Agjencive të Pavarura, nenit 24 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, nenit 20 të Ligjit nr. 04/L-250 për Agjencinë e Shërbimeve të Navigacionit Ajror dhe nenit 13 dhe 15 të Rregullores së AAC-së nr. 3/2016 mbi përcaktimin e skemës së përbashkët të tarifave për shërbimet e navigacionit ajror, dt. 10 shkurt 2016 (“Rregullorja”),

Duke vendosur sipas propozimit final të Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror (“ASHNA”), dt. 8 nëntor 2024, për tarifën njësi terminale për vitin 2025,

Drejtorit të përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës merr këtë:


### VENDIM

1. Refuzohet miratimi i tarifës njësi terminale 2025 prej 361.82 EUR siç është propozuar nga ASHNA më dt. 8 nëntor 2024.
2. Përcaktohet tarifa njësi terminale 2025 në Republikën e Kosovës në vlerë prej 333 EUR.
3. Kjo tarifë u ngarkohet kompanive ajrore nga ASHNA për shërbimet terminale të navigacionit ajror që Agjencia ofron në hapësirën ajrore të Republikës së Kosovës duke filluar nga data 1 janar 2025.
4. Obligohet ASHNA që të kërkojë aprovim nga AAC për çdo ndryshim në projektet kapitale të aprovuara që të financohen me tarifën njësi terminale 2025.
5. Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij.

### ARSYETIM

Me qëllim të vlerësimit të propozimit të ASHNA-s për përcaktimin e tarifës njësi terminale për vitin 2025, AAC-ja ka marrë parasysh dokumentacionin si në vijim:

- Pasqyrat financiare të ASHNA-së për vitin 2023, dt. 20 mars 2024;
- Dokumentet e dorëzuara nga ASHNA gjatë raportimit të parë (kostoja bazë fillestare për të dhënë shërbimin në vitin 2025 përmes tabelave të raportimit nga shtojca II dhe VI e Rregullores 3/2016), dt. 02 prill 2024 me numër protokolli 2024/ZDP/122;
- Raportin vjetor të punës të vitit 2023, dt. 02 prill 2024;
- Konkluzionet e AAC-së nga përmbyllja e shqyrtimit rregullator të raportimit të parë të ASHNA-së sa i përket tarifës njësi 2025 të cilat i janë komunikuar ASHNA-s më 13 qershor 2024;



- Raportin mbi pasqyrat financiare të ASHNA-s të dt. 29 maj 2024 për vitin financiar të përfunduar më 31 dhjetor 2023 dhe Raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit të publikuar në qershor 2024 për pasqyrat financiare të ASHNA-s për vitin 2023;
- Dokumentet e dorëzuara nga ASHNA gjatë raportimit të dytë (kostoja bazë përfundimtare për të dhënë shërbim gjatë vitit 2025 përmes tabelave të Raportimit nga shtojca II dhe VI e Rregullores), më dt. 12 shtator 2024 me numër protokolli 2024/BNRREA/275;
- Dokumentin “Additional info for unit rate” të përditësuar nga ASHNA më 19 shtator 2024;
- Kërkesën buxhetore të ASHNA dërguar në MFPT bazuar në Qarkoren Buxhetore 2025/01, 12 shtator 2024;
- Qarkoren buxhetore 2025/02 të MFPT, dt. 10 tetor 2024, si dhe kërkesën buxhetore të ASHNA-s 2025/27 bazuar në Qarkoren buxhetore 2025/02 për vitet 2025-2027 drejtuar MFPT të dt. 15 tetor 2024;
- Projektligjin mbi ndarjet buxhetore të buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2025;
- Raportin e shpenzimit të buxhetit janar-nëntor dhe raportin e trajnimeve të realizuara gjatë vitit 2024 për ASHNA-n të datës 27 nëntor 2024;
- Raportin e realizimit të buxhetit 1 janar-3 dhjetor të ASHNA dhe planifikimet buxhetore për vitin 2025 nga MFPT me dt. 03 dhjetor 2024;
- Përgjigjet e ASHNA në pyetjet e dërguara në lidhje me numrin e pozitive, shpenzimet operative, zhvlerësimin, koston e kapitalit dhe dëshmitë mbi investimet; më 25 tetor 2024;
- Dokumentet e përditësuara të dorëzuara nga ASHNA gjatë raportimit të dytë të plotësuar e ndryshuar (kostoja bazë përfundimtare për të dhënë shërbimin gjatë vitit 2025 përmes tabelave të Raportimit nga shtojca II dhe VI e Rregullores), dt. 8 nëntor 2024;
- Planin e aprovuar të trajnimeve të ASHNA-s për vitin 2025, i dërguar në AAC më 22 nëntor 2024;
- Opinionin e Avokatit të Popullit në lidhje me pushimet vjetore, me numër A.nr 505/2021 e dt. 14 prill 2022 të dërguar në AAC më 22 nëntor 2024 dhe Njoftimin për përcjellje të udhezimit nga DMZP lidhur me llogaritjen e ditëve të pushimit sipas legjislacionit të zbatueshëm, e dërguar më 22 nëntor 2024;
- Raportin preliminar të njërive terminale të shërbimit (TSU) për muajt nëntor dhe dhjetor 2024 të dorëzuar nga ASHNA më 06 nëntor 2024 dhe 5 dhjetor 2024;
- Parashikimin e numrit të udhëtarëve dhe të fluturimeve për muajt e fundit të vitit 2024 si dhe të vitit 2025 të dorëzuar nga LKIA të dt. 25 nëntor 2024;
- Dëshmitë mbi realizimin e projekteve kapitale 2024 të aprovuara nga AAC-ja të dërguara nga ASHNA në periudhën 21 nëntor-5 dhjetor 2024;
- Planin vjetor të biznesit të ASHNA për vitin 2025, të datës 2 dhjetor të dërguar në AAC më 3 dhjetor 2024;
- Planin e biznesit për periudhën 2025-2029 të ASHNA të datës 2 dhjetor të dërguar në AAC më 3 dhjetor 2024;
- Raportin mbi propozimin e tarifës terminale njësi 2025 të hartuar nga ASHNA dhe të shpërndarë te kompanitë ajrore për konsultime në pajtim me nenin 15 të Rregullores nr. 3/2016 të AAC-së, dt. 11 nëntor 2024;
- Raportimin nga ASHNA të dt. 3 dhjetor 2024 se pas përmbylljes së afatit tre javor të konsultimit publik (12 nëntor - 02 dhjetor 2024) në lidhje me përcaktimin e tarifës terminale, nuk kanë pranuar komente nga kompanitë ajrore;
- Obligacionet qeveritare 10 vjeçare të Bankës Qendrore të Kosovës të publikuara më 5 shtator 2024 në ankandin për obligacione nga BQK;
- Informatat dhe dokumentacionin shtesë që është pranuar nga ASHNA përmes komunikimit elektronik në periudhën tetor-dhjetor 2024 me qëllim të përcaktimit të tarifës njësi terminale për vitin 2025 gjatë periudhës së shqyrtimit;



- Takimet me zyrtarë të ASHNA-së në lidhje me tarifën njësi terminale 2025, më 13 qershor, 28 gusht dhe 30 tetor 2024.

### **Kostot për paga dhe mëditje:**

Për vitin 2025, ASHNA në propozimin final të dërguar më 8 nëntor 2024 ka propozuar një kosto prej 3,893 milion EUR për paga dhe mëditje të 192 punëtorëve që përfshin edhe pagesat për shtesat (përvojën e punës, shtesat për punë jashtë orarit, shtesat për kushtet e tregut të punës dhe shtesat transitore si dhe kompensimin e ditëve të pushimit vjetor të grumbulluara sipas vendimit të Avokatit të Popullit dhe DMZP-së). Kjo kosto përfaqëson një rritje prej 8.3% në krahasim me përcaktimin e AAC-së për këtë kategori për vitin 2024. Kostoja e propozuar është rritur, mes tjerash, për shkak të 33 pozitave të reja që planifikohen të rekrutohen më 2025 (24 kontrollorë të rinjë të trafikut ajror duke arritur në 54 gjithsejtë, 5 inxhinierë të rinjë duke arritur në 11 gjithsejtë, 2 studentë parashikues meteorologjik aeronautik, 1 teknik mirëmbajtjeje dhe 1 zyrtar i pasurisë). Faktor i theksuar kontribues në koston e pagave që në vazhdimësi është rritur është pagesa për punë jashtë orarit që për vitin 2025 arrin vlerën 595,680.74 EUR. Për shkak se kostoja e shtesave për punë jashtë orarit dhe festa gjatë viteve ka pasur trend rritjeje, AAC kërkon që ASHNA të rrisë disiplinën e shpenzimit në këtë aspekt, sidomos të adresoj orët shtesë të cilat ngritin kostot.

Duke pasur parasysh kërkesën e Rregullores, sipas të cilës vetëm kosto e stafit që pritet të japin shërbimin gjatë vitit 2025 duhet t'i ngarkohet kompanive ajrore, AAC-ja ka bërë analizën e këtyre kostove dhe ka vërejtur se në kosto janë futur pagat për 12 muaj për kontrollorët e rinj gjë që nuk mund të realizohet për shkak se procedura për rekrutimin e tyre nuk ka filluar. Pas rikalkulimit, AAC ka përcaktuar si të arsyeshme dhe pranueshme koston e pagave prej 3.85 milion EUR për paga, shtesat në pagë dhe kompensimet tjera. Numri i përcaktuar i personelit është 192 aq sa ka përcaktuar projektligji për ndarjet buxhetore 2025 për ASHNA-n.

### **Kostot tjera operative:**

Në propozimin final të datës 8 nëntor 2024 ASHNA ka propozuar kostot operative në vlerë prej 2.715 milion EUR apo 9% më shumë se sa ka përcaktuar AAC-ja për vitin 2024.

AAC ka shqyrtuar listën e shpenzimeve operative 2025 që mban vlerën totale prej 2,715,176 milion EUR në të cilën ka vërejtur se si edhe vitet paraprake linjat me koston më të lartë janë Trajnimet (790,000 EUR) dhe Mirëmbajtja (544,500 EUR).

Gjatë shqyrtimit të realizimit të buxhetit për vitin 2024 është konstatuar që ASHNA deri më 5 dhjetor të vitit 2024 ka realizuar vetëm 206,984 EUR të linjës së trajnimeve nga 790,233 EUR sa ishin aprovuar nga AAC-ja kryesisht për shkak të mosrekrutimit/trajnitimit të 12 kontrollorëve të rinj që sipas ASHNA kjo vlerë është rreth 500,000 EUR. Sa i përket mirëmbajtjes, vërehet që nga 664,000 EUR sa janë aprovuar nga AAC-ja për vitin 2024 deri më 5 dhjetor 2024 janë shpenzuar 330,992 EUR. Theksojmë se ky trend i mos realizimit të buxhetit të mirëmbajtjes, është prezent në vitet e fundit që tregojnë për planifikim jo të duhur dhe menaxhim jo të duhur të realizimit të shpenzimeve në këtë kategori andaj kërkon trajtim të veçantë nga menaxhmenti i ASHNA meqenëse vetëm se e rrit borxhin ndaj kompanive ajrore.

Sipas të dhënave nga Ministria e Financave, deri më 3 dhjetor 2024, ASHNA ka realizuar buxhetin për kosto operative në vlerë prej 1.194 milion EUR që i bie se janë realizuar 48% të kostove operative të miratuara nga AAC për vitin 2024. Ndërkaq, sipas deklaramentit të ASHNA të datës 4 dhjetor 2024 realizimi i kostove tjera operative pritet të arrijë në 70% deri në fund të vitit 2024 pas pagesës së disa zotimeve.

Pasi ka shqyrtuar secilën linjë të kostove operative të parapara për vitin 2025 dhe raportin e realizimit të buxhetit gjatë vitit 2024, dhe duke pasur parasysh metodologjinë e rregullores sipas së cilës kompanitë ajrore nuk duhet të paguajnë më tepër sesa kostot e shkaktuara, AAC-ja ka përcaktuar si të arsyeshëm dhe pranueshëm një buxhet operativ prej 2,443 milion EUR për vitin 2025 që përfshin edhe shpenzimet komunale prej 145,500 EUR.

## **Kostoja e zhvlerësimit dhe kostoja e kapitalit:**

ASHNA ka propozuar që kosto e kapitalit dhe zhvlerësimit për vitin 2025 të jetë 927,152 EUR prej të cilave kosto e zhvlerësimit në vlerë prej 807,902 EUR ndërsa kosto e kapitalit në vlerë prej 119,251 EUR.

### **a) Kostoja e zhvlerësimit të aseteve aktuale**

AAC ka vërejtur se lista e aseteve të rregulluara 2025 është përditësuar për të përfshirë asetet që janë financuar nga tarifa terminale e navigacionit 2024 (1. Automjete 2. Inventar për nevoja operative 3. Rregullimi dhe renovimi i hapësirave të punës 4. Furnizim me ndërprerës KVM 5. Energji e ripërtëritshme 6. Pajisje për Linjat e dedikuara me shtetet fqinje Voice + Data 7. Radio për sistemin e komunikimit tokë-tokë dhe 8. Azhurnim i radarit në Golesh). Prej këtyre 8 projekteve kapitale të aprovuara nga AAC për vitin 2024 janë realizuar plotësisht dhe kanë hyrë në funksion gjatë vitit 2024 projektet 1,2, 3 ndërsa nr. 7 pritet të hyjë në funksion më 1 janar 2025 rrjedhimisht janë kosto të pranueshme zhvlerësimi që nga 1 janari 2025. Sidoqoftë, për projektet tjera kapitale me numër 4,5,6, dhe 8 ASHNA ka llogaritur se zhvlerësimi i tyre fillon nga 1 janari 2025 gjë që nuk është dëshmuar. Në bazë të dëshmive të mbledhura nga ASHNA dhe platformës së prokurimit publik rezulton se projektet me numër 4 dhe 5 (Energji e ripërtëritshme dhe Furnizim me ndërprerës KVM) janë anuluar prandaj AAC nuk i njuh kostot e zhvlerësimit për këto dy projekte. Ndërsa pasi që për projektin me numër 8 kontrata është nënshkruar në fillim të dhjetorit e për projektin nr.6 ishte në nënshkrim e sipër konkludohet se këto asete nuk pritet të hyjnë në funksion nga 1 janari 2025. Shqyrtimi rregullator ka treguar se një pjesë e madhe e projekteve kapitale të aprovuara që të financohen nga tarifa është iniciuar në platformën publike të prokurimit në 4 mujorin e fundit të vitit 2024 dhe kjo ka sjellë tek situata që ato të mos hyjnë në shërbim të kompanive ajrore gjatë vitit 2024 siç ishte paraparë. Duke pasur parasysh metodologjinë specifike të njohjes së zhvlerësimit paraprak për asetet e reja AAC kërkon që iniciimi i projekteve kapitale të financuara nga tarifa terminale e navigacionit të bëhet në fillim të vitit. Duke qenë se në koston e ofrimit të shërbimit mund të futen vetëm ato asete të cilat janë në funksion gjatë vitit tarifor, AAC ka shtyrë datat e fillimit të zhvlerësimit prej 1 janar 2025 të propozuar nga ASHNA në 1 mars 2025 për dy projektet e cekura më lartë dhe rrjedhimisht kostoja e pranueshme e zhvlerësimit të aseteve aktuale është 724,268 EUR.

### **b) Kostoja e zhvlerësimit të aseteve të reja**

Sa i përket koston së zhvlerësimit të aseteve të reja, AAC ka vërejtur që në bazën e rregulluar të aseteve ASHNA ka futur asetet e 6 projekteve të reja të planifikuara për vitin 2025 dhe për secilat ka parashikuar një periudhë kohore të arsyeshme se kur pritet të hyjnë në funksion si dhe zhvlerësimin përkatës. AAC e aprovon këtë kosto të zhvlerësimit të aseteve të reja përpos koston së zhvlerësimit të katit të dytë të ndërtesës së ASHNA për arsyet e cekura në seksionin pasardhës të Vendimit që flet mbi Projektet kapitale të aprovuara. Rrjedhimisht, kosto e pranueshme e zhvlerësimit të aseteve të reja është 36,535 EUR. Pas ndryshimeve të cekura më lartë del se vlera e zhvlerësimit të aseteve aktuale dhe atyre të reja që pritet të hyjnë në shërbim të kompanive ajrore rrjedhimisht të pranueshme është 760,802 EUR.

### **c) Kostoja e kapitalit**

Kostoja e kapitalit të propozuar nga ASHNA në vlerë prej 119,251 EUR poashtu është ndryshuar për të reflektuar projektet kapitale të aprovuara nga AAC për t'u financuar nga tarifa në vitin 2025 si dhe mesataren e ponderuar të normës së interesit mbi borxhet dhe të kthimit nga kapitali në vlerë prej 4.38% duke rezultuar në vlerën prej 143,722 EUR.

Sa i përket mesatares së ponderuar të normës së interesit mbi borxhet dhe të kthimit nga kapitali ASHNA në raportimin final ka propozuar që të jetë 3.35%. Në bazë të shtojcës 3 të Manualit të ICAO-s mbi ekonominë e shërbimeve të navigacionit ajror dhe seksionit 1 të pikës 4 të Udhëzuesit të EUROCONTROL-it mbi sistemin

e tarifave të rutave, AAC-ja ka analizuar obligacionet qeveritare 10 vjeçare të Bankës Qendrore të Kosovës dhe gjatë vitit 2024, nga rezultatet e publikuara të ankandit për obligacionet qeveritare 10 vjeçare nga Banka Qendrore e Kosovës më 5 shtator 2024 norma mesatare e ponderuar është 4.38%. Në bazë të këtyre të dhënave AAC-ja ka vendosur që mesatarja e ponderuar e normës së interesit mbi borxhet dhe kthimit të kapitalit të jetë 4.38%.

Pas finalizimit të listës së rregulluar të asetëve, kalkulimit të zhvlerësimit dhe kosto të kapitalit si për asetet që janë në funksion më 2024 ashtu edhe për ato që planifikohen të futen në funksion gjatë 2025 dhe aplikimit të normës prej 4.38%, AAC-ja ka përcaktuar që kosto e zhvlerësimit dhe kosto e kapitalit për vitin 2025 të jetë 904,523 EUR.

### Projektet kapitale të aprovuara:

ASHNA ka dorëzuar një listë të projekteve kapitale në vlerë prej 1.050 milion EUR të cilat ka propozuar që të financohen gjatë vitit 2025 nga tarifa terminale e navigacionit 2025.

AAC ka analizuar këtë listë të projekteve kapitale, arsyeshmërinë në dispozicion si dhe nivelin e realizimit të projekteve kapitale të monitoruar ndër vite dhe ka vendosur që t'i pranoj si kosto të arsyeshme projektet kapitale në vlerë prej 750,000 EUR në funksion të ofrimit të shërbimit për kompanitë ajrore si në vijim:

Projekti kapital	Vlera e përgjithshme
AMHS (Automatic message handling system)	600,000 EUR
Rregullimi dhe renovimi i hapësirave të punës	28,608 EUR
Pajisje për linjat e dedikuara me shtetet fqinje Voice+Data	31,392 EUR
Blerja e mobiljeve dhe inventarit	10,000 EUR
Furnizim me UPS industrial	80,000 EUR
<b>Gjithsej</b>	<b>750,000 EUR</b>

Në listën e projekteve të propozuara nga ASHNA ka qenë edhe ndërtimi i katit të dytë të ndërtesës së ASHNA. Edhe pse AAC mirënjeh nevojën e ASHNA që të zgjerojë hapësirat e objektit për shkak të rritjes së numrit të punëtorëve, duke pasur parasysh se ky projekt është në fazën fillestare dhe nuk na është vënë në dispozicion as projekti ideor me parallogari e as lejet për ndërtimin e këtij objekti e ka të pamundur ta aprovojë këtë projekt kapital. Poashtu kjo u është komunikuar zyrtarëve të ASHNA në mënyrë që të zëvendësohet me një projekt tjetër por deri në lëshim të Vendimit nuk ka pasur ndonjë kërkesë të ASHNA.

Në bazë të pikës 2.3.3.2 të Doc. N° 20.60.01 të Eurocontrol "Principles for establishing the cost-base for en route charges and the calculation of the unit rates" "*në mënyrë që hapësirat dhe shërbimet të mirren parasysh në tarifën e atij viti, ato duhet ose të jenë në funksion ose pritjet të hyjnë në funksion deri në fund të atij viti*".

Duke marrë parasysh se ASHNA ka qenë në dijeni për rregullën e përshkruar më lartë dhe pasi që poashtu nuk ka dorëzuar asnjë dëshmi për të mbështetur se kati i dytë funksionalizohet në tërësi gjatë vitit 2025 (ndërtimi si dhe pajisja e katit ashtu që prej aty të ipen shërbime për kompanitë ajrore) AAC ka vendosur se projekti nuk mund të ketë efekt tarifor gjatë vitit 2025.

Në kuadër të kosto totale të zhvlerësimit dhe të kosto të kapitalit për vitin 2025, 68,585 EUR janë përfshirë si kosto të ASHNA-s për këto projekte kapitale të reja me pritshmëri që të jenë në funksion për kompanitë ajrore në afate kohore të përcaktuara nga ASHNA gjatë vitit 2025.

BNRREA do të inspektojë realizimin e këtyre projekteve kapitale në vitin e ardhshëm. ASHNA obligohet që të kërkojë aprovim nga AAC për çdo ndryshim në projektet kapitale të aprovuara që të financohen me tarifën njësi terminale 2025.

## **Parashikimi i njësive terminale të shërbimit (TSU) 2025:**

ASHNA ka parashikuar rritje të TSU-ve prej 7% për vitin 2025, respektivisht ka parashikuar se do t'i shërbejë 18,607 njësi nga 17,389 njësi sa ka raportuar në Tabela Raportuese se do t'i shërbejë gjatë vitit 2024. Sidoqoftë, në Raportin preliminar të njësive terminale të shërbimit (TSU) për muajt nëntor dhe dhjetor 2024 të dorëzuar më 05 dhjetor 2024 ASHNA ka raportuar se do t'i shërbejë 17,474 njësi gjatë vitit 2024, nga 17,389 njësi sa i kishin deklaruar fillimisht. ASHNA ka deklaruar se parashikimi prej 7% është bërë në bazë të të dhënave historike.

Parashikimi i saktë i bazës së TSU-ve (viti n) është me rëndësi të veçantë për ASHNA pasi që parashikimi për vitin (n+1) ndërtohet mbi të, ndërsa konstatimi i gabuar nënkupton axhustime të mëdha në vitin n+2.

Operatori i aeroportit në komunikim drejtuar AAC-së ka parashikuar se viti 2024 do të përmbyllet me mbi 4 milion udhëtarë të shërbyer (17% rritje në krahasim me 2023), respektivisht 13,281 nisje të fluturimeve (14% rritje në krahasim me 2023). Sipas LKIA, numri i udhëtarëve në vitin 2025 parashihet të ketë një ngritje prej 8% në krahasim me vitin 2024 ndërsa numri i fluturimeve të ngritet për 11% (nën parashikimin e faktorit të ngarkesës 83% në krahasim me 85% sa ishte gjatë vitit 2024). Ky parashikim është bazuar në Orarin e fluturimeve për sezonin dimër 2024/2025 dhe aplikimeve të pranuar nga kompanitë ajrore për sezonin e verës të vitit 2025. Gjithashtu, sipas LKIA në këtë skenar është marrë për bazë ofrimi i programit nxitës së operatorit të aeroportit LKIA dhe programit nxitës shtetëror që pritet të ofrohet vitin e ardhshëm që rrjedhimisht do të kenë efekt pozitiv në trafik.

Parashikimi i operatorit të aeroportit është ndarë me ASHNA dhe këta të fundit nuk kanë pasur ndonjë vërejtje apo koment në këtë parashikim.

AAC-ja ka bërë një kalkulim mbi trafikun dhe numrin e parashikuar të TSU-ve gjatë vitit 2025 duke u bazuar në të dhënat dhe parashikimin e trafikut nga operatori i aeroportit LKIA si të dhënat më mirë të informuara të numrit të fluturimeve. AAC-ja pret që viti 2024 të përmbyllet me 17,474 njësi terminale të shërbimit ndërsa gjatë vitit 2025 parashikon që do të shërbehen 19,222 njësi terminale që i bie 10% më shumë se në vitin 2024.

## **Përshtatja për vitin 2023:**

Në bazë të Aneksit VI të Rregullores nënmbulimi ose mbimbulimi si rezultat i diferencës midis të hyrave dhe shpenzimeve për vitin 2023 fillon të bartet/përshtatet në vitin 2025.

Sa i përket përshtatjes, gjatë raportimeve ASHNA ka llogaritur saktë një mbimbulim kostoje për vitin 2023 prej 986,725 EUR dhe ka propozuar që kjo vlerë t'iu kthehet kompanive ajrore në 4 vitet e ardhshme.

Në bazë të pasqyrave financiare të ASHNA-s të vitit 2023, përshtatjes përkatëse të zhvlerësimit dhe kostos së kapitalit për projektet kapitale të realizuara gjatë vitit 2023, si dhe përshtatjes nga vitet e kaluara, rezulton se ASHNA ka mbyllur vitin 2023 me një bilanc prej 986,725 EUR. Kjo vlerë do t'i kthehet kompanive ajrore përgjatë 4 viteve (246,681 EUR në secilin vit), dhe do t'i shtohet kësti i mbimbulimit nga vitet 2021 në vlerë prej 70,540 EUR dhe 2022 në vlerë prej 236,677 EUR, që do të rezultojë me 553,897 EUR vlerë që ASHNA duhet t'ia kthej kompanive ajrore gjatë vitit 2025.

Duhet të kihet parasysh që mbimbulimi, në përputhje me pikën 67 të Manualit të EUROCONTROL për tarifa, konsiderohet borxh ndaj përdoruesve dhe si i tillë duhet të bëhet përpjekje që t'u kthehet përdoruesve (kompanive ajrore) në një kohë të arsyeshme, veçanërisht duke konsideruar kapacitetin aktual të ASHNA-s për ta kthyer këtë borxh.

Në bazë të këtyre fakteve dhe konsiderimeve dhe duke pasur parasysh:

- Se propozimi i ASHNA-s për tarifë terminale 2025 në vlerë prej 361.81 EUR i llogaritur nën parashikimin e rritjes së njësive të shërbimit më 2025 për 7% nën bazën prej 18,607 njësive përfaqëson një ulje tarife prej 1% krahasuar me tarifën e vitit 2024 në vlerë prej 360.59 EUR;

- Se ASHNA obligohet sipas Rregullores që të dëshmojë përpjekjet për përmirësimin e efikasitetit të kostove që në kushtet e rritjes së trafikut nënkupton ulje të tarifës për njësi;
- Vendimin nr. 05-V-286, dt. 26 maj 2016, përmes të cilit Kuvendi i Republikës së Kosovës ka udhëzuar AAC-në të ndërmarrë masat e nevojshme nga fushëveprimi i vet për të krijuar një konkurrencë më të madhe në funksion të uljes së çmimeve të udhëtimit;
- Se AAC-ja ka për qëllim të vendosë një balancë midis operatorëve që japin shërbime nën kushtet e monopolit natyror dhe atyre që i pranojnë këto shërbime;
- Nxitjet financiare të ofruara nga operatori i aeroportit dhe të aprovuara nga AAC-ja për të rritur atraktivitetin e aeroportit;
- Nxitjet financiare të ofruara nga Qeveria e Republikës së Kosovës për kompanitë ajrore që pritet të hyjnë në fuqi në këtë vit tarifor;

#### AAC ka vendosur se:

- Tarifa njësi terminale për vitin 2025 të jetë 333 EUR
- Nën parashikimin prej 10% të rritjes së numrit të njërive të shërbyera terminale gjatë vitit 2025 në krahasim me vitin 2024, kostot totale të ASHNA për të dhënë shërbim cilësor dhe të sigurt gjatë vitit 2025, të pranueshme për AAC pritet të jenë 7.20 milion EUR. Këto kosto do të mbulohen nga tarifa terminale e navigacionit dhe të hyrat tjera.

Duke marrë parasysh faktet e cekura më lartë, dhe në pajtim me nenin 14.1, 15.1(f), 21.2 dhe 81 të Ligjit nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil, i ndryshuar me Ligjin Nr.08/L-063 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me racionalizimin dhe vendosjen e vijave llogaridhënëse të Agjencive të Pavarura, nenit 24 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, nenit 20 të Ligjit nr. 04/L-250 për Agjencinë e Shërbimeve të Navigacionit Ajror dhe në përputhje me Rregulloren (AAC) mbi përcaktimin e skemës së përbashkët të tarifave për shërbimet e navigacionit ajror, Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

  
**Burim Dinarama**  
 (UD Drejtori i përgjithshëm)

**Udhëzim mbi mjetin juridik:** Në përputhje me nenin 15.7 të Rregullores nr. 3/2016, brenda 7 ditëve nga data e lëshimit të këtij Vendimi, ASHNA mund të ri-dorëzojë për miratim në AAC propozimin e ri për tarifën njësi terminale për vitin 2025 përmes Tabelave të Raportimit dhe narrativit që përshkruan në hollësi kalkulimin e secilës prej kostove të pranueshme dhe dëshmon nevojën për t'u realizuar këto kosto gjatë vitit 2025. Propozimi i ri duhet të dërgohet në origjinal të shtypur dhe në kopje elektronike në AAC.

#### Iu dërgohet:

- Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror;
- Ministrin të Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
- Komitetit të kompanive ajrore në ANP "Adem Jashari"
- Departamentit Qendror për Partneritet Publiko-Privat, MFPT
- Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës "Adem Jashari"
- Arkivit të AAC-së.